



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

Nr. 15 prot.

Tiranë, më 12.01.2026

URDHËR

Nr. 7 datë, 12.01.2026

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESIT “PËR PROCEDURAT, AFATET KOHORE DHE PËRGJEGJËSITË QË LIDHEN ME KUALIFIKIMIN E MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË AFP, PËR VITIN 2026”

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 21, datë 27.06.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimeve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional”, i ndryshuar me Udhëzimin e MEKI Nr 64, datë 20.02.2024 dhe me Udhëzimin e MEKI Nr 3. Datë 13.08.2025:

URDHËROJ

Miratimin e Udhëzuesit “Për procedurat, afatet kohore dhe përgjegjësitë që lidhen me kualifikimin e mësimeve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2026”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ejvis Gishiti

